

Banka e Shqipërisë

TENDENCAT NË KREDITIM

*Erjona Suljoti, Sofika Note, Anjeza Gazidede dhe Medvin Shehu
Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë*

JANAR 2025

Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.

P Ë R M B A J T J E

<i>HYRJE</i>	<i>5</i>
<i>PËRMBLEDHJE</i>	<i>6</i>
<i>1. KREDIA PËR SEKTORIN PRIVAT</i>	<i>7</i>
<i>2. KREDIA PËR BIZNESE</i>	<i>10</i>
<i>3. KREDIA PËR INDIVIDË</i>	<i>15</i>

HYRJE

Ky material paraqet një panoramë të aktivitetit kreditues në vend dhe në rajon. Në të analizohen të dhënat monetare, normat e interesit, si dhe kushtet e kreditimit, bazuar në Vrojtimin e Aktivitetit Kreditues. Më konkretisht, statistikatat kryesore të analizuara në material janë: a) statistikatat e flukseve reale¹ për aktivitetin kreditues të bankave për sektorin privat; b) të dhënat cilësore të marra nga Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues (VAK); c) statistikatat për normat e interesit të kredisë, si në monedhën vendase ashtu edhe në euro; d) të dhënat monetare dhe normat e interesit për aktivitetin kreditues për vendet e rajonit.

Vendet e rajonit të përfshira në analizë janë: Bullgaria (BU), Kroacia (CR), Kosova (KS), Mali i Zi (MNE), Rumania (RO), Serbia (SR), Polonia (PL), Hungaria (HU), Republika Çeke (CZ), Republika e Maqedonisë së Veriut (RMV).

Materiali mbulon të dhënat e disponueshme deri më 27 janar 2025, të cilat përfshijnë të dhënat monetare dhe financiare në vend deri në muajin dhjetor 2024, dhe të dhënat e Vrojtimin të Aktivitetit Kreditues për tremujorin e katërt të vitit 2024. Të dhënat e kredisë për vendet e rajonit janë deri në muajin nëntor 2024.

¹ Të dhënat e kredisë merren nga bilancet e bankave dhe i referohen financimit për sektorin privat rezident - bizneseve dhe individëve. Nga viti 2022, analiza e portofolit të kredisë bazohet në setin e ri të informacionit të përgatitur nga Departamenti i Statistikave Financiare në linjë me metodologjinë e BQE-së për flukset "reale" të kredisë, të rregulluara si nga lëvizjet e kursit të këmbimit ashtu edhe nga kreditë e nxjerra nga bilanci.

PËRMBLEDHJE

Kredia për sektorin privat ka shfaqur përmirësim të normave të rritjes në të gjithë nënsegmentët e saj në gjashtëmuorin e dytë të vitit 2024, duke reflektuar një kërkesë të lartë për financim- veçanërisht për investime; lehtësimin e kushteve të financimit, si dhe gatishmërinë e bankave për të financuar. Më konkretisht, gjatë kësaj periudhe, vihet re:

Kredia për biznese ka vijuar të rritet me norma të larta dhe ka qenë kontribuuesi kryesor në zgjerimin e kredisë totale. Brenda këtij segmenti, kredia dhënë biznesit të madh është ajo që ka ndikuar më së shumti, dhe ka mbështetur rikthimin e normave të larta të rritjes së kredisë në valutë të biznesit. Ndërkohë, kredia për biznesin e vogël e të mesëm ka mbajtur një normë të moderuar rritjeje. Në këndvështrimin sektorial, bankat kanë rritur financimin për bizneset në të gjithë sektorët e ekonomisë. Edhe gjatë këtij gjashtëmuorin ka vijuar rritja më e fortë e kredisë për sektorin e turizmit, ndjekur nga sektori i tregtisë dhe industrisë, dhe më pas nga sektori i ndërtimit dhe bujqësisë.

Portofoli i ***kredisë për individë*** është rritur me norma lehtësisht më të larta se më parë. Ky përmirësim ka reflektuar si kërkesën e lartë për financim nga individët, ashtu edhe kushtet financiare që mbetën përgjithësisht të lehtësuara. Një ndikim të rëndësishëm ka pasur edhe zgjerimi i kredisë për blerje banesash, i cili është mbështetur edhe nga programet e qeverisë për kushte të lehtësuara për disa grupe të administratës.


Kushtet çmim dhe joçmim të ofertës për kredi shfaqen më të lehtësuara për bizneset në gjashtëmuorin e dytë, duke reflektuar tolerancën më të lartë të bankave ndaj rrezikut të kreditimit në kushtet e primeve të rrezikut të kontrolluar dhe perspektivës pozitive ekonomike. Për individët, ato shfaqen disi më të shtrenguara, por kryesisht në reflektim të politikave të një banke të sistemit. Në një perspektivë më afatgjatë, kushtet joçmim si për bizneset edhe individët mbeten lehtësuese.

Rritja e ***kredisë për sektorin privat në vendet e rajonit*** është përmirësuar në gjysmën e dytë të vitit 2024, në pjesën më të madhe të vendeve. Krahas vijimit të rritjes së kredisë për individë, ky gjashtëmuorin shënon edhe një rikuperim më të qëndrueshëm të rritjes së kredisë për biznese. Zgjerimi i kredisë është përkrahur nga lehtësimi i kushteve të kreditimit dhe lehtësimi i politikës monetare. Vendet e Ballkanit reflektojnë një performancë krahasimisht më të mirë ndaj atyre të Evropës Qendrore. Shqipëria dallon për norma të larta të rritjes së kredisë, si për individët, ashtu edhe për bizneset.

1. KREDIA PËR SEKTORIN PRIVAT

Kredia për sektorin privat ka shfaqur norma të larta rritjeje, në përgjigje të lehtësimit të mëtejshëm të kushteve financiare, forcimit të besimit, si dhe të zgjerimit ekonomik. Rritja në gjashtëmuorin e dytë është dukshëm më e lartë se ajo e gjashtëmuorit të parë dhe vihet re në të gjitha kategoritë. Më e fortë kjo rritje ka qenë në segmentin e investimeve, si për biznese, ashtu edhe për individë. Ndërkohë, kredia për likuiditet dhe ajo për konsum shfaqën një përmirësim më të njëtrajtshëm. Edhe në prizmin rajonal, aktiviteti kreditues i bankave është përmirësuar në pjesën më të madhe të vendeve. Shqipëria dallon për norma të larta të rritjes së kredisë, si për individët, ashtu edhe për bizneset.

Lehtësimi i kushteve monetare në pjesën e dytë të vitit së bashku me zgjerimin me ritme të larta të aktivitetit ekonomik në vend duket se kanë mbështetur **përmirësimin e normave të rritjes së kredisë për sektorin privat**. Gjithashtu, bilancet e shëndetshme të bankave kanë ndihmuar në gatishmërinë e bankave për t'iu përgjigjur kërkesës së shtuar të bizneseve dhe individëve në reflektim edhe të forcimit të besimit në ekonomi dhe pritjeve për vijimësinë e ciklit pozitiv në ekonomi edhe në të ardhmen. Kështu, kredia për sektorin privat u rrit me 16% mesatarisht në gjashtëmuorin e dytë të vitit, ose 3 p.p. më e lartë se periudha paraardhëse. Në terma të fluksit, rritja e portofolit ishte rreth 49 miliardë lekë ose 3.8 p.p. e PBB-së. Në rritje është shfaqur edhe raporti i kredisë për sektorin privat ndaj PBB-së në 31.5%², niveli më i lartë i dy viteve të fundit.




Kredia për biznese ishte segmenti që kontribuoi më shumë në përmirësimin e normave të rritjes, ndërsa individët dhanë një kontribut më të qëndrueshëm.

² Raporti llogaritet duke u bazuar në publikimin më të fundit të serisë së PBB-së të publikuar nga INSTAT-i, në dhjetor 2024. Ky publikim paraqiti një rishikim të ndjeshëm të serisë të paktën për tre vitet e fundit.


Kështu, rritja vjetore mesatare e secilit grup ishte përkatësisht 16.6% dhe 15%, ose 4.5 p.p dhe 1 p.p më e lartë se në gjashtëmuajorin e parë të vitit. Në muajin dhjetor 2024, kredia për bizneset vlerësohet në rreth 18.7% të PBB-së, ndërsa ajo për individë në rreth 12.8% të PBB-së.

Sipas afatit të maturimit të kredisë, kredia afatgjatë ka dhënë kontributin kryesor në përmirësimin e normave të rritjes së portofolit. Kështu, teksa portofoli i kredisë afatshkurtër dhe afatmesëm shfaqën një përmirësim të moderuar të ritmeve të rritjes me përkatësisht 1.1 p.p. dhe 0.3 p.p., portofoli për kredinë afatgjatë shënoi zgjerim me 4.4 pp, duke arritur kështu në nivelin 18.3% vmv, dhe duke prekur nivelet maksimale historike. Këto dinamika kanë reflektuar profilin e madhësisë së biznesit – ku ka dominuar biznesi i madh si dhe qëllimin kryesor të përdorimit të financimit- për investime. Kjo e fundit është mbështetur jo vetëm nga financimi i projekteve të mëdha specifike të bizneseve, por edhe nga kredia e individëve për blerje banese. Si pasojë e këtyre dinamikave, shpërndarja strukturore e portofolit ka ndryshuar lehtësisht krahasuar me një vit më parë. Kështu, kredia afatgjatë dominon portofolin e kredisë, duke përfaqësuar rreth 65% të totalit.




Në planin rajonal, kredia për sektorin privat në vendet e Evropës Qendrore dhe ato të Ballkanit ka shënuar rritje të mëtejshme në gjysmën e dytë të vitit 2024. Ajo është mbështetur nga vijimësia e rritjes së kredisë për individë dhe nga rimëkëmbja e kredisë për biznese. Në këtë tablo vijojnë të jenë të pranishme divergjencat gjeografike, ku vendet e Ballkanit vazhdojnë të kenë një performancë më të mirë krahasuar me vendet e Evropës Qendrore. Shqipëria renditet mes vendeve me rritjen më të shpejtë të kredisë, si për bizneset, ashtu edhe për individët.

Grafik 3. Ecuria e kredisë për sektorin privat në rajonin e Ballkanit dhe të Evropës Qendrore



Zgjerimi i kredisë në gjashtëmuorin e dytë të vitit 2024 është mbështetur nga lehtësimi i kushteve të kreditimit dhe reduktimi i normave të interesit. Sipas rezultateve të Vrojimit të Aktivitetit Kreditues (VAK) për vendet e Evropës Qendrore e Juglindore, të kryer nga Banka Evropiane e Investimeve³, gjashtëmuorin i dytë i vitit që kaloi shënoi për herë të parë lehtësim të kushteve të kreditimit, pas rreth dy vitesh shtrëngim të tyre. Megjithatë, ky lehtësim vlerësohet ende i brishtë, i kushtëzuar nga kufizimet rregullative në BE, dhe në vendet e rajonit, nga shtrëngimet e kushteve të financimit për bankat mëma, si dhe, në disa prej vendeve, nga perspektiva e ekonomisë. Nga ana tjetër, kërkesa për kredi, e cila ka qenë vazhdimisht në rritje pas periudhës së pandemisë, pritet të vijojë më tej në këtë drejtim.

Grafik 4. Normat bazë (majtas) dhe kërkesa e oferta për kredi (djathtas) në vendet e Ballkanit dhe të EQ



³ Sikurse raportohet në VAK-un për vendet e EQJL-së të përpiluar nga Banka Evropiane e Investimeve. Për më shumë detaje, mund t'i referoheni materialit të mëposhtëm: <https://www.eib.org/en/publications/20240262-cesee-bls-2024-h2>.

Një faktor që ka përkrahur rritjen e kredisë në vendet e rajonit ka qenë reduktimi i normave bazë të interesit nga bankat qendrore. Kjo tendencë, që në disa prej vendeve filloi që në fund të vitit 2023, është përkthyer në norma më të ulëta interesi për financimin e sektorit privat. Megjithatë, normat bazë mbeten ende të larta dhe në territor shtrëngues në shumë prej vendeve të marra në këtë analizë. Kjo është veçanërisht e dallueshme në vendet e Evropës Qendrore, në të cilat rritja e kreditimit është ende e plogësht.

2. KREDIA PËR BIZNESE


Zgjerimi me ritme më të shpejta i kredisë për bizneset ka qenë kontribuuesi kryesor në normat e larta të rritjes së kredisë për sektorin privat. Brenda këtij segmenti vihet re një rritje e fortë e kredisë për biznesin e madh, një përmirësim i asaj për biznesin e vogël dhe ngadalësim për kredinë e kategorisë së biznesit të mesëm. Sipas sektorëve të ekonomisë, zgjerimi i shpejtë i kredisë për bizneset është kanalizuar kryesisht në sektorët e industrisë, tregtisë dhe turizmit. Ecuria e kredisë për bizneset në vendet e rajonit evidenton një rikuperim më të qëndrueshëm të rritjes së kredisë për biznese.

Normat e larta të rritjes së **kredisë për biznese** kanë vijuar edhe në gjashtëmujorin e dytë të vitit, duke arritur një tjetër nivel maksimal prej 16.6%, mesatarisht rreth 4.6 p.p. më të larta se fillimi i vitit. Zgjerimi i shpejtë i kredisë për biznese ka reflektuar kërkesën e lartë për financim nga bizneset, në kuadër të zgjerimit të shpejtë të aktivitetit ekonomik, nevojës për rritjen e kapaciteteve prodhuese, forcimin e besimit si dhe pritjet pozitive për të ardhmen. Paralelisht, edhe bankat janë treguar të gatshme për të akomoduar këtë kërkesë, në kushtet e likuiditetit, kapitalizimit dhe cilësisë së mirë të portofolit në bilancet e tyre duke mundësuar edhe transmetimin më të mirë të kushteve më të lehtësuara financiare në përgjithësi.

Kredia për biznesin e madh është promotori kryesor i përsheptimit të normave të rritjes. Zgjerimi vjetor i këtij portofoli, me 27.7%, ishte rreth dy herë më i lartë se ai i shënuar në pjesën e parë të vitit. Zgjerimi i këtij portofoli ka qenë i lartë, si në lekë ashtu edhe në valutë, por teksa në segmentin në lekë, rritja ka qenë e ngjashme me gjashtëmujorin e parë, ajo në valutë ka shfaqur një zgjerim tre herë më të fortë - i ndikuar edhe nga ulja e kostos së kredisë në euro, në përgjigje të zhvillimeve në tregjet ndërkombëtare.

Nga ana tjetër, kredia për biznesin e vogël shënoi një rritje mesatare prej 12% ose 4 p.p. më shumë se gjashtë muaj më parë, ndërsa ajo për biznesin e mesëm shfaqti ngadalësim në 3.8%, si norma më e ulët e tre viteve të fundit. Këto dinamika brenda nënsegmenteve të kredisë për biznesin kanë përcaktuar edhe zhvendosjen e strukturës së kredisë drejt biznesit të madh, i cili përfaqëson 53.7% të totalit, ose 5.4 p.p. më shumë se një vit më parë.

Grafik 5. Kredia për bizneset sipas madhësisë




Bankat kanë rritur financimin e bizneseve në të gjithë sektorët e ekonomisë, dhe rritja vjetore e portofolit është dyshifrore për të pesta kategoritë kryesore, por më e fortë ajo ka qenë për sektorin e hoteleri - turizmit. Zgjerimi vjetor i këtij portofoli me 25%, ishte 5 p.p më i lartë se norma e shënuar në periudhën paraardhëse. Gjithashtu përshpejtim të ndjeshëm shënoi edhe kredia për sektorin e industrisë dhe tregtisë me norma të larta rritjeje përkatësisht me 20%⁴ dhe 15.8%. Ndërkohë, kredia për sektorin e ndërtimit dhe për bujqësinë shënoi një rritje me mesatarisht 16.5% dhe 11.4%.

Këto zhvillime konfirmojnë se kërkesa e lartë për financim vjen nga bizneset e të gjithë sektorëve ekonomikë dhe bankat (vmv në %). Më e theksuar kjo kërkesë ka qenë për investime të lidhura si me sektorin energjetik- projekte për energjinë e rinovueshme; ashtu edhe me sektorin e hotelerisë, si dhe me sektorët që lidhen me hallka të tjera të zinxhirit ekonomik dhe që reflektojnë interesin e shtuar për turizëm në vendin tonë.

Në fund të vitit, shpërndarja sektoriale ka mbetur përgjithësisht e njëjtë me atë të qershorit 2024, ku sektori i tregtisë dominon portofolin me 43.8% të totalit, më pas renditet ai i industrisë që zë 20.8%, sektori i ndërtimeve dhe shërbimeve të tjera përfaqësojnë secili rreth 16.5% ndaj totalit, dhe sektori i bujqësisë me një peshë minimale prej 1.3%. Këto zhvillime janë në linjë me kontributin sektorial të tyre në rritjen e aktivitetit ekonomik në vend.

⁴ Kredia për sektorin e industrisë më shumë se rritje të financimit real për veprimtarinë e sektorit ka reflektuar efektin e një kredie të madhe dhënë biznesit në sektorin e energjetikës për shlyerjen e financimit të marrë jashtë vendit.

Grafik 6. Kredia për bizneset sipas sektorëve të ekonomisë




Interesat e kredisë në lekë për bizneset në gjysmën e dytë të vitit kanë shfaqur ecuri rënëse. Ulja e normës bazë dy herë në këtë periudhë është përcjellë gradualisht dhe me ritëm të ndryshëm brenda kategorive specifike të kredisë. Interesat e kredisë për shuma deri 35 mln lekë, që kërkohen kryesisht nga biznesi i vogël janë shfaqur më të qëndrueshme dhe kanë regjistruar ulje të lehta kryesisht në tremujorin e fundit. Interesat e kredisë për shuma mbi 35 mln lekë, krahas luhatjeve që e dallojnë këtë segment kanë treguar dhe ulje më të shpejtë. Ndërkohë, interesat e kredisë në euro kanë vijuar rënie. Lehtësimi i shpejtë i politikës monetare nga Banka Qendrore Evropiane është reflektuar tek interesat e kredisë në euro në vend dhe ka diktuar ecurinë e tyre në gjysmën e dytë të vitit.

Norma mesatare e interesit për kreditë e reja në lekë për bizneset në tremujorin e fundit zbriti në 6.4% nga 6.7% që ishte në gjashtëmujorin e parë të vitit. Interesat janë ulur lehtësisht tek të tre kategoritë, ndonëse ishte kategoria e kredive mbi 140 mln lekë ajo që ndikoi më shumë në muajt e fundit. Interesi mesatar për këto kredi regjistroi 5.9% në tremujorin e fundit nga 6.1%, 6.7% dhe 6.6% në tre tremujorët paraardhës. Interesat tek kategoria e kredive me shuma deri 35 mln lekë kanë regjistruar ulje të përmbajtur, por gjithsesi të vazhdueshme që prej muajit korrik.

Interesi për këtë kategori shënoi vlerën 7.4% në muajin e fundit (dhjetor) nga 7.6% që ishte vlera e tij mesatare në gjysmën e parë të vitit. Kostot e financimit për likuiditet afatshkurtër kanë ruajtur afërsisht të njëjtin nivel, ku interesat për overdraft dhe kapital qarkullues në pjesën e dytë të vitit rezultuan 6.4%, ashtu si në gjysmën e parë të tij. Analiza sipas fiksimit fillestar të interesit tregon se interesat janë ulur si tek kredia me normë fillestare të fiksuar deri në një vit, ashtu edhe tek ajo me normë të fiksuar mbi një vit. Ulja ka qenë më e fortë tek kjo e fundit, interesat e së cilës shënuan mesatarisht 6.7% krahasuar me 7.2% që ishin në 6-mujorin e parë. Ndërkohë që kategoria tjetër shënoi vlerën 6.1% nga 6.4% që ishte në pjesën e parë të vitit.


Grafik 7. Ecuria e normave të interesit për kreditë në lekë sipas madhësisë së kredisë (majtas) dhe fiksimit fillestar të interesit (djathtas) për bizneset private



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Interesat për kreditë në euro të bizneseve kanë rënë dukshëm në pjesën e dytë të vitit, duke reflektuar kahun lehtësues të ndjekur nga BQE gjatë kësaj periudhe. Norma e interesit në tremujorin e fundit rezultoi 6.1% nga 7.0% që shënonte kjo normë në gjysmën e parë të vitit. Analiza sipas madhësisë së kredisë evidenton se interesat janë ulur qenësishëm tek të dyja kategoritë. Interesi i kredisë për shuma deri 250 mijë euro rezultoi 6.3% në tremujorin e fundit, nga 7.1% që ishte ky tregues në pjesën e parë të vitit, ndërsa kategoria e kredive mbi këtë shumë shënoi vlerën 6.0% nga 7.0% krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë. Analiza sipas fiksimit fillestar të interesit evidenton se interesat tek kredia me normë të fiksuar deri në një vit kanë regjistruar ulje më të madhe se ato me fiksimit fillestar mbi një vit. Ndërkohë, interesat për overdraft dhe kapital qarkullues kanë regjistruar ulje minimale krahasuar me kategoritë e tjera. Interesat për financim afatshkurtër rezultuan 6.0% në tremujorin e fundit, nga 6.2% në gjysmën e parë të vitit.


Grafik 8. Ecuria e normave të interesit për kreditë në euro sipas madhësisë së kredisë (majtas) dhe fiksimit fillestar të interesit (djathtas) për bizneset private




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Bankat vijuan të ndjekin politika lehtësuese kreditimi për bizneset edhe në gjysmën e dytë të vitit 2024. Në terma mesatarë, kushtet dhe termat e kreditimit të bizneseve u lehtësuan në gjysmën e dytë, ndonëse në atë të fundit ato mbetën të pandryshuara nga një tremujor më parë. Standardet e kreditimit të huatë akorduar bizneseve mbetën të pandryshuara në gjysmën e dytë, të cilësuar si të tilla për dy vite me radhë. Faktorët që kanë mbështetur vendimet e bankave për kreditë akorduar bizneseve gjatë gjysmës së dytë të vitit ishin ambienti më i favorshëm i normave të interesit, si dhe një perceptim më pozitiv rreth zhvillimeve aktuale dhe të pritura makroekonomike.

Krahas aplikimit të marzheve më të ulëta mbi kreditë e reja, bankat shtuan edhe madhësinë e kredisë akorduar bizneseve në gjashtëmujorin e dytë të vitit. Elementët e tjerë joçmimformues të kredisë për bizneset nuk shfaqën ndryshime të mëdha në këtë periudhë, me përjashtim të kushtëzimeve të marrëveshjes së kredisë së nënshkruar mes palëve. Ky tregues vijoi të shënojë balancë neto negative, megjithatë ai ishte në nivele më të ulëta krahasuar me mesataren e shënuar një vit më parë.



Kredia për biznese ka shënuar përmirësim të rritjes vjetore në pothuajse të gjitha vendet e rajonit. Rritja e saj është përsheptuar ndjeshëm në vendet e Ballkanit, ndërsa vijon ende e dobët në vendet e Evropës Qendrore. Në Shqipëri, zgjerimi i shpejtë i kredisë për biznese gjatë këtij viti shënoi rikuperim të plotë pas një periudhe ngadalësimi krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit gjatë periudhës 2022 – 2023. Për gjashtë muajt e fundit, rezultatet e VAK-ut për vendet e rajonit evidentojnë një përqendrim të kërkesës së bizneseve kryesisht për kredi për kapital qarkullues. Në gjashtë muajt e ardhshëm, pritet një rritje e mëtejshme e kërkesës për financim, e dominuar nga kërkesa për kredi për investime.




3. KREDIA PËR INDIVIDË

Portofoli i kredisë për individë është rritur me norma lehtësisht më të larta se më parë. Ky përmirësim ka reflektuar si kërkesën e lartë për financim nga individët, ashtu edhe kushtet financiare që mbetën përgjithësisht të lehtësuara. Një ecuri të ngjashme ka pasur kjo kredi edhe në vendet e rajonit.

Kredia për individë është rritur me mesatarisht 1.5% vmv në gjashtëmujorin e dytë të vitit, duke u zgjeruar me rreth 1 p.p. nga më parë dhe duke prekur kështu nivelet më të larta të shfaqura gjatë 5 viteve të fundit. Megjithatë, në ndryshim nga gjashtëmujori i parë, krahas rritjes së shpejtë të kredisë në Lekë, përmirësim ka shfaqur edhe kreditimi në Euro. Norma vjetore e këtij portofoli u rikthye në terren pozitiv pas muajit gusht, duke shënuar një rritje vjetore mesatare prej 1.5%. Ngushtimi i diferencës së normave të interesit midis kredive në Lek dhe atyre në Euro pas muajve të verës, me fillimin e ciklit të politikës lehtësuese të BQE-së duket se riktheu në vëmendje të individëve kreditimin në Euro.

Pavarësisht këtij zhvillimi, kjo normë rritjeje është shumë më e ulët krahasuar me normat e larta dyshifrore që po shfaq segmenti në Lek i këtij portofoli. Gjatë gjashtëmujorit të dytë, kredia në Lek për individët u rrit mesatarisht me 21.6%. Kjo normë është e njëjtë me atë të shënuar në pjesën e parë të vitit. Në përmbledhje të këtyre dinamikave, raporti i kredisë në Lek ndaj totalit të kredisë për individët u rrit më tej në 74.3% të totalit.



Shpërndarja sipas qëllimit të përdorimit të financimit, tregon se kredia konsumatore ka ruajtur të njëjtën normë rritjeje sikurse edhe në gjashtëmujorin e parë prej 15.3%. Ndërkohë, normat e përmirësuara i dedikohen plotësisht kreditimit më të lartë për blerje banesash. Kështu, kjo kredi u rrit mesatarisht me 17.4%, normë kjo rreth 1.8 pp më e lartë se ajo e periudhës pararendëse. Segmenti i kredisë hipotekare është segmenti kryesor ku është kanalizuar rikthimi i moderuar i kreditimit në valutë të individëve. Gjithashtu zgjerimi i këtij portofoli është ndikuar edhe nga programet mbështetëse me kushte lehtësuese të dhënë nga autoritet qeveritare.


Rritja e tepicës së kredisë hipotekare prej 14 miliardë lekë është e ngjashme me rritjen në gjashtëmujorin e parë- nivele këto që shënojnë vlera të larta historike për këtë segment. Në fund të vitit, kredia për banesa përbën rreth 67.4% të portofolit në total ose rreth 1 p.p. më shumë se fundi i vitit 2023, ndërkohë që ajo për konsum qëndron lehtësisht më lart, duke arritur në nivelin prej 28.4%⁵.

Normat e interesit për kreditë në lekë për individët në gjysmën e dytë të vitit janë ulur, duke reflektuar një përcjellje të shpejtë të ndryshimeve të normës bazë. Interesat e kredisë për individë kanë përfitur edhe nga ecuria rënëse e yield-it të bonos 12-mujore, i cili përdoret gjerësisht në indeksimin e pjesës më të madhe të kredive të kësaj kategorie. Interesi i kredisë hipotekare në euro ka rënë këta muaj, duke e ngushtuar kështu diferencën me interesat e kredisë në Lek (diferenca vijon të jetë në terren negativ).


Interesat e kredisë në lekë për individë janë ulur gjatë gjysmës së dytë të vitit, si për kredinë konsumatore ashtu edhe për atë hipotekare. Ulja e normës bazë dy herë në këtë periudhë dhe ecuria rënëse e yield-it 12-mujor kanë diktuar në prirjen e interesave tek kjo kategori. Interesi mesatar për kredinë konsumatore në këtë interval kohe rezultoi 8.7% nga 9.6% që ishte në gjysmën e parë të vitit. Interesi i kredisë për blerje banese zbriti në 3.7% në tremujorin e fundit

⁵ Ndërkohë që kredi të tjera përbëjnë pjesën e mbetur prej 4.4% të portofolit, lehtësisht më e ulët se në vitin 2023.


nga një mesatare 4.3% e pjesës së parë të vitit të kaluar. Analiza sipas periudhës së fiksimit fillestar të normës së interesit tek kredia për shtëpi tregon se tek kreditë me fiksimit fillestar deri në një vit, interesat janë ulur më shumë sesa tek kategoria me fiksimit fillestar mbi një vit. Në tremujorin e fundit, ato rezultuan respektivisht 3.2% dhe 4.2% nga 3.9% dhe 4.5% që ishin vlerat mesatare në gjysmën e parë të vitit.



Ashtu si për bizneset, edhe **interesi i kredisë së re në euro për individët** ka regjistruar ulje të shpejtë këta muaj, duke reflektuar kështu ndryshimet e normës bazë të interesit nga BQE. Interesi mesatar i kredisë për blerje banese zbriti në 4.9% në tremujorin e fundit krahasuar me 5.6% që shënonte ky tregues në gjysmën e parë të vitit. Normat e interesit janë ulur dukshëm dhe afërsisht me të njëjtën madhësi si tek kreditë me normë interesi të fiksuar deri në një vit, ashtu edhe tek ato mbi një vit. Diferenca midis interesit të kredisë hipotekare në lekë dhe asaj në euro është ngushtuar.



Bankat përgjithësisht kanë mbajtur të pandryshuar kushtet e kreditimit ndaj individëve gjatë gjysmës së dytë të vitit 2024. Me përjashtim të një banke, kushtet dhe termat e kreditimit për kreditë e reja akorduar individëve kanë mbetur të pandryshuara gjatë kësaj periudhe. Ambienti ku bankat veprojnë vijon të mbetet konkurrues, çka ka bërë që ato të mbështesin kërkesat për kredi të individëve duke shtuar madhësinë e kredisë së aprovuar për individët gjatë gjysmës së dytë të vitit. Elementët e tjerë joçmim nuk ndryshuan në gjysmën e dytë të vitit.



Kredia për individë ka vijuar të rritet me ritme të larta. Në mënyrë të ngjashme me ecurinë e kredisë për biznese, ajo ka shfaqur një ecuri më të mirë **në vendet e Ballkanit krahasuar me vendet e Evropës Qendrore**. Sipas informacionit të përfutur nga VAK për vendet e rajonit, kërkesa e individëve për kredi ka qenë e lartë, si për blerje të pasurive të paluajtshme, ashtu edhe për konsum. Ajo ka reflektuar përmirësimin e besimit konsumator dhe perspektivën e mirë të tregut të pasurive të paluajtshme, faktorë këta që do të vijojnë të rrisin kërkesën për kredi të individëve edhe në gjashtë muajt e ardhshëm.

